



European Bank
for Reconstruction and Development

KOSOVO **SMIE**

Competitiveness Support Programme

***Ndërtimi i NVM-ve
konkurruese në Kosovë***



RRETH PROGRAMIT

Programi për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në Kosovë synon të përmirësojë konkurrueshmërinë e NVM-ve dhe mundësitë e tyre për tregtim në rajon dhe me shtetet e BE-së, përmes investimeve të selektuara dhe të mbështetura me grante. Programi është një kombinim i qasjes në financa, granteve dhe asistencës teknike për të rritur njohuritë e NVM-ve. Programi është zhvilluar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ndërsa grantet dhe asistencë teknike janë financuar nga Bashkimi European (BE) në kuadër të Instrumentit për Asistencë Para-Anëtarësimit.

Asistencë teknike u ndihmon NVM-ve t'u japin prioritet investimeve që i përmbushin Direktivat e BE-së.

Perspektiva e anëtarësimit në BE shfaq shumë mundësi për NVM-të e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe Kosovën. Sidoqoftë, progresi i adaptimit të *acquis communautaire* përfshinë ndryshime të rëndësishme rregullative, duke shtuar nevojën për investime në mënyrë që ndërmarrjet të përshtaten me standardet e reja.

Programi për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së NVM-ve në Kosovë është zhvilluar për të ndihmuar NVM-të të plotësojnë rregullat e reja dhe të kuptojnë kërkesat për përmirësim në fushën e mbrojtjes së ambientit, mirëqenies dhe sigurisë në punë dhe kualitetit dhe sigurisë së produktit.

Një grant prej 15% i financuar nga fondet IPA të BE-së, ju ndihmon NVM-ve të bëjnë investime konkrete që rrisin konkurrueshmërinë e tyre.

Programi i ri ofron kredi nga BERZH përmes bankave lokale partnere të kombinuara me një grant prej 15% të financuar nga fondet IPA të BE-së. Në kuadër të Programit ofrohet poashtu edhe asistencë teknike që ju mundëson NVM-ve të optimizojnë nevojat investive për të arritur përpueshmëri me Direktivat Prioritare të BE-së. Ndonjëherë një zgjidhje e lehtë mund të përmbush kriterin, por shpesh kërkohet një

qasje më komplekse. Komponenti i asistencës teknike është dizajnuar për të adresuar pikeërisht këtë.



European
Union
Kosovo

ÇFARË KREDI JANË NË DISPOZICION?

Projektet mund të financohen me një ose më shumë kredi me vlerë totale deri në 1 milion EUR për çdo kompani ose grup të kompanive.

Projektet investuese duhet të përmirësojnë konkurrueshmërinë e kompanisë në çfarëdo tregu dhe të arrijnë përpuethshmëri me një ose më shumë Direktiva të BE-së në fushën e mbrojtjes së ambientit, eficiencën e energjisë, sigurinë e punëtorëve, kualitetit dhe sigurisë së produktit. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar do ta vlerësoj projektin tuaj dhe nëse ju dëshironi, do t'ju këshillojë në alternativa tjera apo më të mira, në mënyrë që të arrini qëllimin tuaj.



PSE DUHET TA KONSIDERONI PROGRAMIN PËR MBËSHTETJEN E KONKURRUESHMËRISË SË NVM-VE NË KOSOVË PËR INVESTIMIN TUAJ:

GRANTI – Pas verifikimit të suksesshëm të projektit tuaj investues, ju e fitoni mundësinë për një rimbursim në formë granti në deri 15% - një mënyrë e mirë për të zvogëluar shpenzimet e financimit të investimit tuaj. Rimbursimi në formë granti financohet nga fondet IPA të BE-së.

KRITERE TË THJESHTA – Kreditë dhe grantet në Programin për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së NVM-ve në Kosovë janë në dispozicion për çfarëdo investimi i cili ndihmon kompaninë tuaj të përmbushë direktivat e BE-së, duke rritur kështu potencialin tuaj të zgjerimit të tregut dhe të fitimeve.

PËRFITIMET E ZGJERIMIT TË EKSPORTIT TË BIZNESIT SI DHE TREGJEVE TUAJA NË SHETIMIN TUAJ – Të gjitha investimet e pranueshme përmirësojnë kualitetin e produktit. Kjo ju mundëson të rrisni tregtinë e eksportit në Evropë, mirëpo kualiteti i përmirësuar ju përmirëson pozitën konkurruese në vend DHE jashtë vendit.

FITIME MË TË LARTA – Thjeshtë, të gjitha investimet e pranueshme mund të rezultojnë në zvogëlim të konsumit të energjisë dhe resurseve, duke ulur koston tuaj bazë dhe duke rritur avantazhin konkurrues si dhe mundësinë e fitimeve më të larta.

KONTRIBUIMI NË EKONOMINË E GJELBËR – Të gjitha investimet e përshtatshme zvogëlojnë ndotësit sic janë emetimet e gazrave të dëmshëm.

MBËSHTETJE FALAS NGA EKSPERTËT – Procedurat e kombinuara me asistencë teknike pa pagesë të ofruara nga ekipi ndërkombëtar i ekspertëve ju ndihmojnë të merrni rrugën e duhur drejt tregjeve të reja.

HISTORI SUKSESI

Një kompani që prodhon mobilje prej druri dhe bën prerje dhe formimin e dërrasave ka investuar në pajisje të përpunimit të drurit

Investimi në:

- HOLZ-HER sharrë me presion me rreze Tectra 6210 Fuqi
- HOLZ-HER 7125 Black Edition Qendër për punë me makinë
- PRO-MASTER 7125 Black Edition

Investimi & Granti:

Investimi total: 156,000 EUR

kredi: 140,000 EUR

grant (15%): 21,000 EUR

Direktivat e BE-së që janë plotësuar:

- Direktiva 2014/35/EU
- Direktiva 2006/42/EC
- Direktiva 95/16/EC (e rimodeluar)
- Direktiva 2014/30/EU (e rimodeluar)
- Direktiva 2009/125 (e rimodeluar)



KUSH MUND TË APLIKOJË

Kompanitë si vijon mund të aplikojnë në kuadër të Programit për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së NVM-ve në Kosovë:

- NVM-të, entitetet tjera si dhe individët e regjistruar si ndërmarrës apo të angazhuar në aktivitete ekonomike në përputhshmëri me ligjet e shtetit.
- Kompania e cila operon në Kosovë
- Kompania që ka më pak se 250 punëtor dhe qarkullimi vjetor i së cilës NUK është mbi 50 milion EUR, dhe/ose ka një vlerë totale të pasurive që NUK tejkalon 43 milion EUR.
- Kompania duhet të jetë në pronësi private.
- Aplikanti ka marrë të gjitha aprovimet dhe lejet e nevojshme dhe është në përputhje me legjislaturën mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë.
- Aplikuesi NUK është i përfshirë në listën e BERZH të personave apo trupave të papërshtatshëm për të përfituar një kontratë të financuar nga BERZH.
- Kompanitë, bizneset, individët apo trupat në vazhdim NUK MUND të aplikojnë për kredi apo grant përmes Programit të Mbështetjes së Konkurrueshmërisë së NVM-ve në Kosovë:
 - armë apo pajisje ushtarake;
 - institucione financiare apo kompani të shërbimeve financiare apo biznese të sigurimeve;
 - kompanitë dhe bizneset të përfshira në prodhimin apo shitjen e duhanit apo pijeve alkoolike;
 - kazinot apo pajisje tjera bixhozi;
 - kompanitë dhe bizneset e përfshira në investime spekulative në pronë apo valuta apo çfarëdo investimi spekulativ;
 - çfarëdo aktiviteti që ekziston në Listën e Përfshirjes së Mjedisor apo Social të BERZH

HISTORI SUKSESI

Një kompani e produkteve të qumështit investoi në pajisje të prodhimit të djathit dhe jogurtit, depo ftohëse dhe një bojler të ri

Investimi në:

- Pajisje të prodhimit të djathit
- Kazan për ftohje
- Bojler të ujit të nxehtë

Investimi & Granti:

Investimi total: 148.500 EUR

Kredia: 148.000 EUR

Grant (15%): 22.275 EUR

Direktivat e BE-së që janë plotësuar:

- Direktiva 2014/35/EU
- Direktiva 2006/42/EC (e rimodeluar)
- Direktiva 2014/30/EU
- Direktiva 2001/81/EC
- Direktiva 2010/75/EU



CILAT PROJEKTE INVESTIVE PRANOHEN?

Të gjitha investimet duhet të përmirësojnë përpuethshmërinë me një ose më shumë Direktiva të BE-së në fushën e mbrojtjes së ambientit, sigurisë së punëtorëve dhe sigurisë dhe kualitetit të produktit, ashtu sikurse janë të listuara në Direktivat Prioritare të BE-së, apo me një Direktivë të BE-së (ndryshe nga Direktivat Prioritare të BE-së) që është konfirmuar nga Konsulenti i Projektit. Kjo përfshin, për shembull:

- Makineri të re, pajisje prodhimi, linja prodhimi
- Ngrohës uji të ri, sisteme të ftohjes, pompa të nxehjes
- Riparimi dhe ndërtimi i ndërtesave prodhuese
- Riparimi i integruar dhe ndërtimi i linjave prodhuese dhe ndërtesave
- Riparimi dhe ndërtimi i pajisjeve të magazinimit, dhomave të ftohta, depove duke përfshirë mjetet e brendshme të transportit
- Makineri për paketim
- Kamionët dhe riomorkiot
- Pajisjet për lëvizjen e dheut
- Sistemet e ruajtjes së drithërave, mullinjtë, bimët që ushqejnë kafshët
- Pajisjet për shumimin e kafshëve (lopëve, shpendëve, pulave, etj)
- Sistemet e aspirimit dhe reduktimit të pluhurit
- Makina për trajtimin e ujërave të papërdorur
- Makina për reduktimin e emitimeve në ajër
- Energji e rinovueshme

Përveç të lartëpërmendura, mund të aplikohen edhe këto kritere specifike:

Pajisje të Dorës së Dytë

Rekomandohet të fokusoheni në pajisje të reja. Financimi i pajisjeve të dorës së dytë është i mundshëm nëse në kushte të jashtëzakonshme pajisja është vlerësuar tërësisht nga Konsulentët e Projektit dhe nëse kushtet në vijim plotësohen:

- Pajisja është riparuar tërësisht
- Pajisja ka një garancion nga furnitori për së paku 6 muaj
- Dëshmohet paaënësia e kostos së investimit në krahasim me pajisjet e reja

Automjetet

Automjetet e reja janë të pranueshme për kredi dhe grant përmes Programit nëse:

- përdoren vetëm për qëllime biznesore
- zëvendësojnë automjete të vjetra (dëshmia e mos-operimit të automjetit të vjetër duhet të sigurohet)
- plotëson standardet e parapara të BE-së

Kriteret e detajuara të mëposhtme ekzistojnë për llojet e ndryshme të automjeteve, përveç kriterëve të lartpërmendura:

- Taxi: Automjetet duhet të jenë vetura hibride
- Kamionet: së paku plotësojnë normën Euro 6;
- Furgonat: së paku plotësojnë normën Euro 6, të regjistruar me ligjet lokale për transportit e mallrave për qëllime komerciale dhe rreptësisht për biznes
- Autobusët: së paku plotësojnë normën Euro 6, në linjë me biznesin e kompanisë (transport të pasagjerëve)

Automjetet e dorës së dytë nuk pranohen.

Lokalet industriale

Blerja e lokaleve industriale dhe renovimi i lokaleve në vete pranohet për financim në rast se investimi rrit:

- Shëndetin dhe sigurinë në punë
- Mbrojtjen e ambientit
- Sigurinë dhe kualitetin e produktit
- Eficiencën e energjisë

në përputhje me Direktivat e BE-së sikurse parashihet në ligjet lokale.

Renovimi i ndërtesave ekzistuese apo ndërtimi i objekteve të reja poashtu pranohet, nëse plotësohen qëllimet dhe kriteret e njejta sikurse përshkruhen më lartë.

SI TË APLIKONI

Procesi i aplikimit përmban hapat e rreshtuar më poshtë. Ju lutemi kërkoni ndihmë nga ekipi ynë teknik në çdo kohë gjatë procesit:

- Format e Aplikimit që mund të shkarkohen nga ueb faqja www.web-sme-csp.com mund të dërgohen direkt tek bankat partnere (PB) apo tek Konsulenti i Projektit (PC)
- PC mbështet PB-të në vlerësimin e pranueshmërisë teknike të një NVM-je dhe të investimit të tyre
- Vendimi i financimit të një investimi ose jo bëhet nga bankat partnere
- Ekipi ynë teknik do të përgatis Planin e Investimit së bashku me juve dhe do të përcaktoj nevojat konkrete për investim në mënyrë që të arrihet përmbushja e Direktivave të BE-së.
- Në momentin kur investimi është kompletuar, granti do të paguhet në momentin që bëhet verifikimi nga Konsulenti i Verifikimit.

BANKAT TONA PARTNERE

Për ta thjeshtësuar procesin, të gjithë mekanizmat financiar janë në dispozicion nëpërmjet Bankave Partnere, të cilat marrin mbështetje të vazhdueshme nga Konsulentët e Programit.

Kushtet e kreditimit vendosen nga Bankat Partnere dhe vendimi përfundimtar për financimin e një kompanie aplikuese bëhet vetëm nga Bankat Partnere. BERZH, BE dhe Konsulentët e Projektit nuk kanë asnjë ndikim në këtë vendim.

Konsulenti i Projektit është përgjegjës për vlerësimin teknik të projekteve investuese dhe, së bashku me Konsulentin e Verifikimit, për të vendosur dhe të shqyrtuar vlerat e grantit. Bankat Partnere do t'u paguajnë grantet pronarëve të projekteve të kompletuara dhe verifikuara me sukses.

Megjithatë, Bankat nuk kanë ndikim në nivelin e granteve që jepen.

Ju lutemi vizitoni ueb-faqen tonë për përditësime në lidhje me Bankat Partnere të Programit të Mbështetjes së Konkurrueshmërisë të NVM-ve në Ballkanit Perëndimor. (www.web-sme-csp.com).

HISTORI SUKSESI

Një kompani që prodhon fruta dhe perime investoi në pajisje për depo të ftohjes për të përmirësuar PQS

Investimi në:

- Frigoriferë me panele, pajisje të ftohjes, dhomat e shokut për trajtimin dhe mirëmbajtjen e produkteve, kapacitet total prej 2000 ton
- Implementimin e sistemeve HACCP

Investimi & Granti:

Investimi Total: 470.000 EUR

Kredi: 460.000 EUR

Grant (15%): 69.000 EUR

Direktivat e BE-së që janë plotësuar:

- Direktiva 2014/35/EU
- Direktiva 2014/30/EU (e rimodeluar)
- Direktiva 2009/125 (e rimodeluar)
- Rregulli (EC) No 1005/2009
- Rregulli (EU) No 687/2010



HISTORI SUKSESI

Një kompani që është në biznesin e prodhimit dhe shpërndarjen e birrës, pijeve jo-alkoolike dhe ujit, investoi në pajisje të reja:

Investimi në:

- SSY 5555 Makinë për paketim automatik me sistem Overlap
- Linjë për mbushjen e kanaceve me birrë

Investimi & Granti:

Investimi total: 998,326 EUR

Kredi: 993,326 EUR

Granti (15%): 148,999 EUR

Direktivat e BE-së që janë plotësuar:

- Direktiva 89/654/EEC
- Direktiva 2009/104/EC
- Direktiva 89/391/EEC
- Direktiva 2009/104/EC
- Direktiva 2014/35/EU
- Direktiva 2006/42/EC (e rimodeluar)
- Direktiva 2014/30/EU (e rimodeluar)



HISTORI SUKSESI

Një prodhues i materialeve plastike të paketimit (politilen tereftalat) investoi në një sistem për tharjen e materialeve PET në një sistem të ri të ftohjes

Investimi në:

- Ftohës uji me pompë HP dhe 604 kW kapacitet ftohës nominal
- Sistem i kompletuar Moretto për tharjen e PET

Investimi:

Investimi total: 99,500 EUR

Kredi: 89,550 EUR

Granti (15%): 13,432 EUR

EU Directives met:

- Direktiva e Këshillit 89/655/EEC
- Direktiva 95/63/EC
- Direktiva 2009/104/EC
- Direktiva 2009/104/EC



EKSPERTIZA

Përveç financimeve, kompanitë mund të përfitojnë gjithashtu nga qasja në ekspertizë për të rritur konkurrueshmërinë në tregjet vendore dhe ndërkombëtare. Mund të jetë një sistem i ri i menaxhimit të kualitetit, zhvillimi i një plani të marketingut për eksportimin e produkteve apo adaptimi i procedurave të vendit të punës me standarde të reja - kompanitë mund të përfitojnë nga projektet këshilluese me konsulentët lokalë dhe ndërkombëtarë përmes Programit, me një marrëveshje për ndarjen e kostove.

Këshilla biznesi

Punoni me një konsulent lokal në një projekt për një aspekt specifik të biznesit, si p.sh futjen e një sistemi të ri të menaxhimit të kualitetit që plotëson standardet ISO apo krijimi i një plani të fizibilitetit për një fabrikë të re. Këto projekte shpesh zgjasin 4-6 muaj dhe aplikojnë praktikën më të mirë për të ndihmuar biznesin të bëhet më konkurrues. Deri në 50% të kostove të këtyre projekteve rimbursohen. Kjo këshillë mbulon fushat e specializuara të ekspertizës, duke përfshirë:

- strategji
- marketing
- organizimi
- operacionet
- teknologjia
- zgjidhje inxhinierike
- menaxhimi i kualitetit
- menaxhimi financiar
- efienca e energjisë dhe ambienti

Ekspertiza e industrisë

Sigurohuni që biznesi juaj mund të konkurrojë në arenën ndërkombëtare duke marrë ekspertizën e një këshilluesi ndërkombëtar të industrisë së njejtë. Duke shkëmbyer përvojën e tyre shumëvjeçare ndërkombëtare nga menaxhimi i asaj industrie, ai ose ajo mund të ju ndihmojë që në mënyrë strategjike të shqyrtoni çdo aspekt të biznesit dhe të zhvilloni një strategji të besueshme për investim dhe rritje. Mund të jetë njohuri e specializuar për nivelet e duhura të lagështisë së tjerres së leshit, standardet laboratorike për prodhimin farmaceutik apo përzgjedhjen e pajisjeve më efektive për të përmirësuar prodhimin, këta këshilltarë ndërkombëtar kuptojnë se si këto çështje lidhen me çdo biznes dhe nevojat e tij. Këto projekte zakonisht marrin mes 12-18 muaj.

Lidhuni me ndërmarrës të tjerë dhe forconi njohuritë tuaja për eksport

Trajnimi i promovimit të eksportit nga BERZH për NVM-të mund të ndihmojë kompanitë të kuptojnë bazat e eksportit, duke përfshirë identifikimin e tregut të duhur dhe dinamikat e produktit, dhe planifikimet e eksportit dhe specifikat e BE-së. BERZH poashtu organizon ngjarje, trajnime dhe mundësi kontakti me ndërmarrës. Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni knowhowkosovo@ebrd.com

Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Instrumentit European për Ndhimën e Para-Anëtarësimit. Pikëpamjet e shprehura këtu janë të Konsulentit dhe prandaj nuk mund të merren në asnjë mënyrë për të pasqyruar opinionin zyrtar të Bashkimit European.



European
Union
Kosovo

KOSOVO SME

Competitiveness Support Programme

info.kosovo@web-sme-csp.com | www.web-sme-csp.com